



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Fjalimi përshëndetës i Guvernatorit

Dhjetor 7, 2023

Konferenca: Nënshkrimi i Marrëveshjes së Rigarancisë me Agjencinë suedeze për Zhvillim
Organizator: Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe SIDA
Koha dhe vendi: 7 dhjetor 2023 ora 09:30-11:00, Swiss Diamond Hotel, Prishtinë

I nderuari, z. Azemi, Kryesues i Bordit të FKGK

I nderuari, z. Westerlund, Ambasador i Suedisë në Kosovë

E nderuara, znj. Hajdari, Ministre MINT

I nderuar, z. Berisha, Drejtor Menaxhues në FKGK

Të nderuar pjesëmarrës,

Kam kënaqësinë të marr pjesë në këtë ngjarje të veçantë të nënshkrimit të Marrëveshjes së Ripërtëritjes të Fasilitetit Garantues ndërmjet Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim (SIDA) që ka në qendër të saj mundësitë që hapin rrugën e ofrimit të kushteve më të favorshme për kreditë e rigarantuara nga dritaret e FKGK sikurse janë Dritarja për Gratë në Biznes, Dritarja për Eksport për mbështetjen e ndërmarrjeve eksportuese dhe Dritarja GROW për investimet e gjelbra që rritin efikasitetin e energjisë dhe gjenerojnë energji nga burimet e ripërtëritshme.

Bankat komerciale dhe institucionet tjera kredidhënëse si institucionet të rregulluara dhe mbikëqyrura nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës luajnë rol të rëndësishëm në kreditimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë së vendit dhe njëkohësisht ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik përmes konsumit, investimeve dhe eksporteve neto.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore si entitet juridik i pavarur dhe me karakter zhvillimor përmes garantimit të portofolit kreditorë të institucioneve financiare historikisht ka kontribuar në rritjen e qasjes në financa për NVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrjes, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve, të cilat krijojnë vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

Rritja e vazhdueshme e kapitalit të FKGK-së kombinuar me skema rigarantuese, duke përfshirë edhe marrëveshjen e sotme të rigarancionit ndërmjet FKGK dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim ndikon në zgjerimin e qasjes në financa, rritjen e konkurrencës, zvogëlimin të hendekut të

financimit me kushte konkurruese, ruajtjen e nivelit të kredive joperformuese dhe të stabilitetit financiar e që janë edhe në përputhje me strategjinë dhe mandatin e BQK-së.

BQK është përkushtuar që të mbështesë çdo nismë ligjore dhe rregullative nga FKGK në funksion të zgjerimit të anëtarësisë edhe të institucioneve mikrofinanciare (kredihënëse), rishikimit të afateve për t'u bërë pjesë e FKGK-së për institucionet e reja bankare si dhe mundësinë për skema të veçanta garantuese të FKGK-së për bankat që të mund të financojnë institucionet mikrofinanciare.

BQK-ja e konsideron FKGK-në si një mekanizëm shumë të rëndësishëm për të mirëmbajtur dhe avancuar edhe më tej objektivin për sistem financiar stabil, me ndikim në mbështetje të ekonomisë. Prandaj edhe bashkëpunimi do të fuqizohet në interes të zbatimit të këtyre objektivave.

Më lejoni që të falënderoj Agjencinë Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze në Kosovë për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë FKGK-së për mbështetjen në garantimin e kredive në funksion të rritjes së kreditimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe me kosto të përballueshme.

Ju faleminderit!